



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e80-të, të mbajtur më 18.01.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-8170/1 i datës 14.09.2022, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.

Lënda me numër 12-8170 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Çështja numër 12-8170/1 datë 14/09/2022 është krijuar në bazë të një aplikimi të paraqitur nga ///, RMV-së me prokurë ///, avokat nga ///, RMV. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen një mosmarrëveshje pronësore-juridike ndërmjet parashtruesit dhe ///, dhe në lidhje me legalizimin e një objekti të ndërtuar pa leje, nga ana e PK /// KK /// dhe nga ana e PK / // KL /// /. Për shumicën e këtyre KP-ve, e drejta trashëgimore e pronësisë është vendosur ndaj parashtruesit, në procedurë verifikimi pas vdekjes së ///. Bëhet fjalë për legalizimin e një ndërtimi pa leje që është ndërtuar nga parashtruesi, dhe jo ///, ndaj thuhet se zyrtarët në /// kanë shpërdoruar pozitën dhe kompetencat e tyre zyrtare, në mënyrë që në procedurën e legalizimit nuk ka marrë parasysh të drejtën e trashëgimit të parashtruesit, të krijuar në procedimin e verifikimit, pas vdekjes së babait të tij. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Ndaj denoncimit janë dorëzuar prova për mbështetje të denoncimeve.

Nga mbikëqyrja në përmbajtjen e denoncimit dhe provave të dorëzuara , KSHPK-ja vlerësoi se lënda nuk elemente për veprim kompetent. Përkatësisht, zgjidhja e marrëdhënieve pronësore-juridike është në kompetencë të gjykatave themelore, përkatësisht Gjykatës Themelore të Kumanovës, në këtë rast.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:
Parashtruesi

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: S. P. D.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar
Mr. Vlladimir Georgiev

